



01Nr. 111/01-10130/2026

Datë:04.05.2026

Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore për zbatim të paragrafit 2.3 të nenit 42 të Ligjit Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik dhe nenit 12 të Rregullores (QRK) nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, bënë këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

Për pranimin e aplikimeve për një (1) Profesor/e i/e fushës së njejtë si anëtar i Komisionit të pranimit për procedurën e rekrutimit në kategorinë e specialistëve, në grupin e Inxhinierisë së ndërtimit

Aplikuesit për anëtar të Komisionit të pranimit për kategorinë e specialistit do ti kryejnë detyrat e tyre sipas Rregullores (QRK) nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe duhet ti plotësojnë kriteret si në vijim:

-Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi, të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët, të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse, të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje, të mos jetë i punësuar në shërbimin civil dhe mos të ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik, të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës, të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pese (5) vitet e fundit;

Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, Inxhinieri strukturore, Inxhinieri arkitekturore, Inxhinieri Gjeoteknike, hidroteknikë.

Pagesa: Pagesa është fikse 250 euro e cila iu paguhet për çdo procedure të konkurimit në të cilën është i angazhuar.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Së bashku me aplikacionin kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin si më poshtë:

- Biografinë (CV-në)
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar.
- Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë.

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi që nuk është i punësuar në shërbimin civil dhe nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik si dhe
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore dhe dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kriteve të përgjithshme të përcaktuara në shpalljen publike dhe të deklaruara në aplikacion.

Mënyra e aplikimit

Formularët e aplikimit merren në Qendrën për shërbim me qytetar dhe në web-faqen komunale dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar kati përdhësë në objektin e Komunës në Kaçanik ose përmes adresës elektronike: kacanik.personeli@rks-gov.net;

Afati për pranimin e aplikacioneve është prej datës 05.05.2026 deri më 12.05.2026

Pas vlerësimit të kandidatëve, Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore publikon listen e kandidatit fitues në web-faqen komunale.

Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë Njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Menaxhere e burimeve njerëzore

